

Pr. 8818

27.6.2023



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
19.06.2023**

Me datë 19.06.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Blediane Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Rudin Beka, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Ulqinaku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, Elmira Ndrevasaj, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Pemdrecaj, Gjovalin Ndoj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Blendi Gjylbegaj, Helga Sallaku, Gjovalin Darragjati, Gloria Shllaku, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amina Lici, Plarent Anamali.

Sekretari i Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes së parë të këshillit.
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

- 1. Zgjedhja e komisionit të mandateve.*
- 2. Miratimi i mandateve dhe betimi i anëtarëve të këshillit.*
- 3. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zv.Kryetarëve të këshillit.*
- 4. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.*
- 5. Zgjedhja e këshilltarëve që përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut.*

Sekretari i këshillit citon listën me emrat e këshilltarëve të konfirmuar sipas vendimit të KQZ dhe më pas fton këshilltarin më të vjetër në moshë, që është i pranishëm në mbledhje për drejtimin e përkohëshëm të mbledhjes. Nga verifikimi i datëlindjeve rezulton më i vjetër Z.Hilmi Lakti.

Nën drejtimin e Z.Lakti vijohet me zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të mandateve. Kërkohen propozimet nga grupet politike.

Grupi i Partise Socialiste propozon Znj.Uarda Albunesa Gjekaj, Grupi i Kualicionit Bashkë Fitojmë propozon Z.Florian Bjanku dhe Grupi i Partisë Social Demokrate propozon Z.Gjovalin Ndoj.

Vijohet me votimin e hapur të anëtarëve të Komisionit të Mandateve, ku rezultojnë 49 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kryetare e këtij komisioni vendoset Znj.Gjekaj, Sekretar Z.Bjanku dhe Anëtar Z.Ndoj. Kryetarja e Komisionit sjell në vëmendje nenin 47 të ligjit 139/2015 për papajtueshmërinë e funksionit të këshilltarit.

Më pas vijohet me verifikimin e mandatit të secilit prej anëtarëve të zgjedhur të Këshillit bashkiak dhe kryhet votimi i hapur për secilin duke theksuar që anëtarët nuk mund të votojnë për vehten e tyre.

Miratohet

Kalohet tek formula e betimit, e cila lexohet nga Sekretari i këshillit me zë të lartë dhe secili thotë "Betohem" duke nënshkruar njëkohësisht.

1.Vijohet me zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak. Propozimet parashtrohen në mënyrë të hapur nga grupet partiake me jo më pak se 5 këshilltarë dhe nuk lejohet që këshilltarët të votojnë vehten e tyre.

Grupi i Këshilltarëve të PS propozon Z.Oltion Luli, grupi i kualicionit Bashkë Fitojmë nuk ka kandidat për kryetar këshilli, po ashtu as grupi i partisë Social Demokrate dhe as grupi i partisë Demokratike. Rezulton kështu që kandidati i vetëm për kryetar i Këshillit bashkiak është Z.Oltion Luli.

Zhvillohet votimi i fshehtë për kryetar këshilli bashkiak. Kryetarja e Komisionit të mandateve thërret nominalisht një nga një këshilltarët për të votuar. Pas mbarimit të procesit të votimit rezultojnë se nga 49 këshilltarë prezent në sallë kanë votuar me vullnetin e tyre të lirë 34 këshilltarë ku 30 Vota janë Pro Z.Oltion Luli, 3 Abstenim dhe 1 fletë e pavlefshme. Mbështetur në ligjin për qeverisjen vendore Kryetari i ri i Këshillit bashkiak zgjidhet me shumicë votash **Z.Oltion Luli**.

Dhe nga ky moment mbledhja drejtohet nga Kryetari i ri, i cili mban fjalën e tij të parë.

Sipas procedures dhe rendit të ditës vijohet me zgjedhjen e zv.kryetarëve të Këshillit bashkiak.

Merren propozimet, së pari nga Partia më e madhe opozitare.

Grupi i Kualicionit Bashkë Fitojmë, konkretisht Znj.Shala, Z.Haxhi, Znj. Ulqinaku, Z.Osmanagaj, Znj.Kopliku, Z.Doci propozojnë për Zv.Kryetare Këshilli Znj.Valjeta Bajraktari,

kurse grupi i Partisë Social Demokrate konkretisht Z.Sokoli, Z.Nika, Znj.Rraboshta, Znj.Pode, Znj.Duhani, Znj.Kopshtari, Z.Bushati propozojnë Znj. Violeta Perndrecaj.

Z.Lakti në emër të grupit të PS mbështet propozimet e bëra.

Hidhen në votim të hapur dhe ndaraz propozimet e ardhura dhe më pas vijohet me votimin e fshehtë. Pas mbarimit të procesit të votimit rezulton se kandidatja për Zv.Kryetare Këshilli Znj. Valjeta Bajraktari ka marrë 41 vota Pro, 4 Abstenim dhe 0 Kundër.

Miratohet

Kurse Kandidatja tjetër Znj. Violeta Perndrecaj ka marrë 34 vota Pro, 5 Abstenim, 4 Kundër dhe rezultojnë 2 fletë votimi të pavlefshme.

Miratohet

3. Kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës ; *Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.*

Fillimisht lexohet nga Kryetari i Këshillit vendimi i gjykatës dhe formula e betimit. Kryetari i Bashkisë betohet dhe mban fjalën e tij përshëndetëse përpara këshillit.

Vijohet me pikën e fundit të rendit të ditës për *Zgjedhjen e këshilltarëve që përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut.* Z.Luli komunikon shkresën e Prefektit për numrin e përfaqësuesve në Këshillin e Qarkut.

Znj.Leqejza në emër të grupit PS, propozon Z.Lakti, Znj.Nika, Z.Ndou, Znj.Petani, Z.Dama, dhe Znj.Kavaja. Z.Sokoli në emër të grupit të PSD propozon Znj.Duhani, kurse Znj.Shala në emër të grupit të kualicionit BF kërkon 5 min kohë para votimit dhe gjithashtu përfaqësim me % në Këshillin e Qarkut. Por Z.Luli sqaron se kjo nuk është e parashikuar ligjërisht në procesin e votimit por është në dorë të këshilltarëve të K.B.

Pas pushimit të kërkuar nga kualicioni BF, konstatohet që sekretari i Komisionit të mandateve pa arsye nuk është më prezent. Për arsye procedurale kryetarja e komisionit i propozon kryetarit të Këshillit që vendi vakant i Z.Bjanku duhet të zëvendësohet por më parë hidhet në votim shkarkimi i tij. Behet votimi i hapur nga ku rezultojnë 41 vota Pro.

Miratohet

Propozohet për vendin vakant në Komisionin e Mandateve Znj.Ulqinaku. Hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 1 votë Abstenim, 0 vota Kundër

Miratohet

Znj.Shala merr fjalën dhe shprehet se pas bisedimeve kualicioni i BF ka vendosur të mos jetë pjesë e këtij procesi votimi.

Kryetarja e Komisionit fillon procesin e votimit të fshehtë për emrat e propozuar dhe pas numërimit të hapur të votave, shpallet rezultati, ku rezulton se morën pjesë 36 këshilltare.

Kandidatët fitues shpallen Znj.Bledianë Nika me 32 vota Pro, Znj.Vjollca Petani me 30 Vota Pro, Znj.Erlinda Kavaja me 32 Vota Pro dhe Znj.Marina Duhani me 33 Vota Pro. Kurse për kandidaturat meshkuj, rezulton fitues Z.Edmond Ndou me 33 vota Pro, Z.Hilmi Lakti me 32 vota Pro dhe Z.Fatbardh Dama me 31 vota Pro.

Kryetari i Këshillit Z.Luli deklaron të mbyllur mbledhjen.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 19.06.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 4 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH



KRYETAR



Olind LULI

